



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.287/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesues, Ferki Xhaferi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesmarrjen e zyrtarit ligjor Besart Ademi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetvendosje, me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajë datë.06.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet ankesa e evidentuara si: Anr.287/2019, të datës 05.10.2019, e paraqitura nga Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK), me seli në Prishtinë, dhe subjektit politik, Lëvizja Vetvendosje, me seli në Prishtinë, i shqiptohet gjobë, në lartësi prej 500.00 (pesëqind) euro, për shkak të vazhimit të sponsorimit të fushatës zgjedhore në rrjetin social “Facebook”, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore, të cilën shumë, subjekti politik detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

Me datë 05.10.2019, PZAP-i ka pranuar ankesën Anr.287/2019, nga Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit Lëvizja Vetvendosje, me seli në Prishtinë, në të cilat pretendon se në llogarinë zyrtare në Instagram, shihe se në ditën e heshtjes zgjedhore me datën 05.10.2019, kandidati për deputet nga radhet e Lëvizja Vetvendosje Taulan Kryeziu, në Instagram ka bërë thirrje për ta votuar. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e ligjit për zgjedhjet e përgjithshme. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara në cilësi të provës materiale.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Lëvizja Vetvendosje ka theksuar se kandidati për deputet i cili është objekt i kësaj ankesë nuk ka publikuar asgjë në afatin e përcaktuar gjatë afatit 24 orëshpara hapjes së vendvotimeve. Për më tepër në ankesën e LDK-së nuk ceket data ose ora e publikimeve të sponsorizuara.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Paneli paraprakisht ka vlerësuar se ankesa: Anr.287/2019, e datës 05.10.2019 e paraqitur nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ndaj Lëvizjës Vetvendosje, nga shkresat e lëndës shihet se si kandidati për deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e Lëvizjës Vetvendosje, Taulant Kryeziu gjatë heshtjës zgjedhore dhe ditës së votimit në rrjetin social Instagram ka bërë fushate zgjedhore dhe ka udhëzuar që të votohet nr 14 dhe kandidati për kryeminister Albin Kurti, ku me këtë veprim ka bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Andaj PZAP-i duke marr parasysh këtë si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se subjekti politik Lëvizjës Vetvendosje, është përgjegjëse për veprimet e saja duke shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku thuhet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja fushatë në çfarëdo mënyre.

Paneli mbi bazën e të dhënave të lartcekuar në mbështetje të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa

Anr.287/2019 më datë 06.10.2019



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.